



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

332/20

26.06.2020



PSH .nr.332/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z.Blerim Dina-Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues dhe z.Goran Milenković - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik grupi i OE “Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove”- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prishtinë me datën: 25.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik, grupi i OE “Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove”- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prishtinë.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës: “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prishtinë dhe lënda kthehet në rivlerësim.

III.Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ndërkaq menaxherit të prokurimit në AK i tërhiqet vërejtja për zbatim të LPP-së në rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorit ekonomik ankesues grupi i OE “Internat Security Association

Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove”- Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI.Obligohet operatori ekonomik ankues grupi i OE “Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove”- Prishtinë, që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik OE grupi i OE “Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove”- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 27.05.2020 me nr. 332/20 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prishtinë. duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1,6,7,59,60,61,72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datës 10.06.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1,

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 10, 52, 59, 61 dhe 72 të LPP-së si dhe nenet 3 dhe 4 të Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët, me rastin e refuzimit të tenderin tone, me arsytimin se:

“Ne jemi detyruar që dy herë deri më tani të paraqesim ankesë edhe pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe po i njejtë institucion ka sygjeruar që AK të respektoj nenin 60 të LPP-së, i cili në asnjë rast nuk është repsektuar duke bërë shkelje dhe mos përfillje të vendimeve të OSHP me nr.82,83,90/2020 dhe nr.735,734,757, për të vazhduar duke mos përfillur poashtu edhe mendimin e ekspertit shqyrtues për dy herë radhazi.

AK ka shpallur fitues konsorciumin "Commando" "Aulona POI" dhe "GFS" edhe përkundër se ky grup OE kishte mangësi në dokumentacion dhe ishte i papërgjegjshëm, e poashtu tash së fundi ka shpallur si fituese kompaninë "Rojet e Nderit" sh.p.k, e cila kompani ka tejkaluar në masë të madhe buxhetin e paraparë të AK, shkelje kjo e cila dëmton dhe paraqet paraprakisht keqpërdorim të parasë publike nga AK, përkatësisht zyra e prokurimit, duke i dhënë një tender gjithsej 728,006.40 euro më të shtrenjtë se tenderi i konsorciumit tonë.

Me dt.19.05.2020 kemi marrë vendimin nga AK në të cilin thuhet se Komuna e Prishtinës shpërblen Rojet e Nderit me cmime me te lire te pergjegjshem"

Derisa tenderi i grupit të OE "I.S.A" sh.p.k dhe "NAZERI 2000" SH.P.K dega në Kosovë, është refuzuar me arsyetimin si tender jo normalisht i ulët".

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesrisht të bazuara sepse AK me rastin e rivlerësimit të ofertave nuk i ka zbatuar në tërësi Vendimin e OSHP-së, PSH nr.735-744-757/19 dt.09.12.2019 dhe Vendimin e OSHP-së, PSH nr. 82, 83, 90 /2020 dt.11.03.2020 duke mos marr parasysh rekomandimet e dalura nga këto vendime që AK me rastin e rivlerësimit të ofertave të merr parasysh qëllimin, menyrën më efikase dhe më transparente qysh parashihet me ligjin për prokurim publik si dhe kërkesat e parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga vetë AK.

Po ashtu eksperti shqyrtues, duke pas parasysh arsyjen e eliminimit të AK-së për grupin e OE ankuese "Bazuar në kërkesat e FDT-së dhe ligjin e punës rrjedh se çmimi juaj 2,379,456.00 € është çmim jonormalisht i ulët", konstaton se nëse merren parasysh vlerat e ofertave financiare të operatorve ekonomik të cilet sipas AK janë të përgjegjshëm administrativisht dhe trajtohen konform nenit 3 dhe 4 të "Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët" atëherë grupi i OE ankues por edhe asnjëri nga operatorët ekonomik pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk i plotësojnë kushtet e parapara për tu trajtuar si operator ekonomik që përmbajn ofertë financiare Jo-normalisht të ulët.

Si dhe hartimi i dosjes se tenderit nga ana e AK-së, respektivisht hartimi i tabelës së përshkrimit të çmimit duke përshkruar vetëm numrin e pozitave dhe orëve pa specifikuar numrin minimal të punëtorve që duhet të angazhojnë operatorët ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, ka lënë hapsirë që operatorët ekonomik të paraqesin ofertën financiare duke planifikuar numrin e punëtorve sipas dëshirës së vetë respektivisht aq sa kanë menduar vetë që është e nevojshme/ të angazhojnë, dhe ky fakt po ashtu paraqet problem për të konstatuar se cila nga ofertat nuk mund ti përmbahen dispozitave të parapara me ligjin e punës.

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka planifikuar buxhet të mjaftueshëm për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse me rastin e inicimit të procedurës në "Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimin e disponueshmërisë së fondeve" është paraqitur buxheti në vlerë prej 2,100,000.00 € (nga 700,000.00 € për secilin vitë 2019,2020 dhe 2021) ndërsa në faqen 3 të kësaj deklarate në pjesën ku

parashihet nenshkrimi i kesaj deklaraten nga zyrtari i prokurimit, zyrtari kryesor financiar dhe zyrtari kryesor administrative me qëllim që të konfirmohet edhe njëher buxheti para se të shpallet vendimi i AK është dhënë deklarata se pajtohen që të shtohet buxheti prej 140,000.00 € për vitin 2019 dhe nga 80,000.00 € për dy vitet tjera, e që nënkupton se aprovimi buxhetor shtesë për këtë aktivitet të prokurimit e rritë buxhetin e planifikuar në vlerë totale prej 2,400,000.00 €, me qka nënkuptohet se AK ka rekomanduar për kontratë Opertarin Ekonomik “**Rojet e Nderit Sh.p.k**”- **Prishtinë**, në vlerë financiare prej: **3,107,462.40 euro**, e cila vlerë e tejkalon buxhetin e planifikuar për **707,462.40 €**, nga kjo rrjedh se AK qysh para hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me Opertarin Ekonomik të rekomanduar për kontratë, me oferten dhe çmimet e ofertuara nga ky OE, kanë informacion se do të tejkalohej pragu apo tavani siç parashihet me nenin 38 të LPP-së.

Bazuar në këto fakte ekspertit mendon se AK me rastin e vlerësimit nuk ka vepruar konform paragrafit 3 të nenit 52 të LPP-se, ku thuhet *“Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike.”*

Po ashtu është vepruar në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së ku thuhet *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”*

Gjithashtu ekspertit shqyrtues konstaton se oferta e operatorit ekonomik ankues është më e lirë në vlerë prej 728,006.40 € se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e grupit të OE ankues të aprovohet si **pjesërisht e bazuara**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe duke pas parasysh se shkeljet e hasura në këtë aktivitet të prokurimit nuk mund të korigjohen në këtë fazë si dhe më qëllim të trajtimit të barabart të të gjithë operatorve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të **Anulohet**, me qëllim që autoriteti kontraktues me rastin e ritenderimit të hartoj kërkesat dhe kritere të matshme në përputhje me aktivitetin e prokurimit si dhe duke respektuar në tërësi ligjin dhe rregullat detyesore për prokurim publik.

Autoriteti Kontraktues, me datën 15.06.2020 me anë të parashtrësës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datën 11.06.2020 me anë të parashtrësës, e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues por nuk pajtohen që ky AP të anulohet.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 10, 52, 59, 61 dhe 72 të LPP-së si dhe nenet 3 dhe 4 të Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët, me rastin e refuzimit të tenderin tone, me arsyetimin se:

"Ne jemi detyruar që dy herë deri më tani të paraqesim ankesë edhe pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe po i njëjti institucion ka sugjeruar që AK të respektoj nenin 60 të LPP-së, i cili në asnjë rast nuk është respektuar duke bërë shkelje dhe mos përfillje të vendimeve të OSHP me nr.82,83,90/2020 dhe nr.735,734,757, për të vazhduar duke mos përfillur po ashtu edhe mendimin e ekspertit shqyrtues për dy herë radhazi.

AK ka shpallur fitues konsorciumin "Commando" "Aulona POI" dhe "GFS" edhe përkundër se ky grup OE kishte mangësi në dokumentacion dhe ishte i pa përgjegjshëm, e po ashtu tash së fundi ka shpallur si fituese kompaninë "Rojet e Nderit" sh.p.k, e cila kompani ka tejkuluar në masë të madhe buxhetin e paraparë të AK, shkelje kjo e cila dëmton dhe paraqet paraprakisht keqpërdorim të parasë publike nga AK, përkatësisht zyra e prokurimit, duke i dhënë një tender gjithsej 728,006.40 euro më të shtrenjtë se tenderi i konsorciumit tonë.

Paneli shqyrtues pasi që shqyrtoj dhe analizoj pretendimin ankimor të OE ankues sqaron se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave nuk i ka zbatuar në tërësi Vendimin e OSHP-së, PSH nr.735-744-757/19 dt.09.12.2019 dhe Vendimin e OSHP-së, PSH nr. 82, 83, 90 /2020 dt.11.03.2020 duke mos marr parasysh rekomandimet e dalura nga këto vendime që AK me rastin e rivlerësimit të ofertave të merr parasysh qëllimin, mënyrën më efikase dhe më transparente qysh parashihet me ligjin për prokurim publik si dhe

kërkesat e parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga vetë AK.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues është eliminuar nga AK me arsyetimin se: “Bazuar në kërkesat e FDT-së dhe ligjin e punës rrjedh se çmimi juaj 2,379,456.00 € është çmim jonormalisht i ulët”. Paneli shqyrtues sqaron se nëse bazohemi në vlerat e ofertave financiare të operatoreve ekonomik të cilët sipas AK janë të përgjegjshëm administrativisht dhe trajtohen konform nenit 3 dhe 4 të “Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët” konstatojmë se grupi i OE ankues por edhe asnjëri nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk mund të konsiderohen si operator ekonomik që përmbajnë ofertë financiare Jo-normalisht të ulët.

Po ashtu, hartimi i dosjes se tenderit nga ana e AK-së, respektivisht hartimi i tabelës se përshkrimit të çmimit duke përshkruar vetëm numrin e pozitive dhe orëve pa specifikuar numrin minimal të punëtorëve që duhet të angazhojnë operatorët ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, ka lënë hapësirë që të njëjtit të paraqesin ofertën financiare duke planifikuar numrin e punëtorëve sipas mendimit të tyre se sa është e nevojshme, fakt ky që po ashtu paraqet problem për të konstatuar se cila nga ofertat nuk mund ti përmbahen dispozitave të parapara me ligjin e punës.

Paneli shqyrtues sqaron se AK nuk ka planifikuar buxhet të mjaftueshëm për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse me rastin e inicimit të procedurës në “Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimin e disponushmeris së fondeve” është paraqitur buxheti në vlerë prej 2,100,000.00 € (nga 700,000.00 € për secilin vite 2019, 2020 dhe 2021) ndërsa në faqen 3 te kësaj deklarate ne pjesën ku parashihet nënshkrimi i kesaj deklaraten nga zyrtari i prokurimit, zyrtari kryesor financiar dhe zyrtari kryesor administrative me qëllim që të konfirmohet edhe njëherë buxheti para se të shpallet vendimi i AK është dhënë deklarata se pajtohen që të shtohet buxheti prej 140,000.00 € për vitin 2019 dhe nga 80,000.00 € për dy vitet tjera, e që nënkupton se aprovimi buxhetor shtesë për këtë aktivitet të prokurimit e rritë buxhetin e planifikuar në vlerë totale prej 2,400,000.00 €, AK ka rekomanduar për kontratë Operuarin Ekonomik “Rojet e Nderit Sh.p.k”- Prishtinë, në vlerë financiare prej: 3,107,462.40 euro, e cila vlerë e tejkalon buxhetin e planifikuar për 707,462.40 €, duke vepruar kështu me nenin 59 dhe 60 të LPP-së pasi që AK nuk ka respektuar kriterin për dhënie të kontratës *Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët*, andaj paneli shqyrtues e vlerëson si të qëndrueshëm pretendimin ankimor të OE ankues se AK ka rekomanduar për kontratë OE me çmimin me të lartë, ngase nga dokumentacioni i lëndës shihet se oferta e operatorit ekonomik ankues është më e lirë në vlerë prej **728,006.40 €** se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit duhet të ketë parasysh nenin 38 të LPP-s-së. Bazuar në këto fakte vlerësojmë se AK me rastin e vlerësimit nuk ka vepruar konform paragrafit 3 te nenit 52 te LPP-se, ku thuhet *“Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në*

lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike.”

Po ashtu është vepruar në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së ku thuhet *”Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, andaj paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK ka zbatuar vetëm pjesërisht kërkesat e veta të parashtruara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.*

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Blen Dina



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi Komunal-Prishtinë.
- 1x1 OE- “Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega në Kosovë”
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.